



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0909

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) N.N.SH. “Vizion Project”, kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit ose një konkursi të projektimit Komuna Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan” me numër të prokurimit 613-23-536-2-2-3, me 31/01/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE N.N.SH. “Vizion Project” me nr. 2023/0909 , e datës 16/11/2023, kurse vendimi i AK Komuna Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan” me numër të prokurimit 613-23-536-2-2-3.

2. **Anullohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan” me nr. të prokurimit: 613-23-536-2-2-3, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna Lipjan”, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e

Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 06.02.2023, Komuna Lipjan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B06 Njoftim për Konkursin e Projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan” me nr. të prokurimit: 613-23-536-2-2-3. Ndërsa me datën 27.10.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 45,000.00 €.

Me 01.11.2023, OE N.N.SH. “Vizion Project” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. 06.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.11.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.N.SH. “Vizion Project”., me nr. 909/23 për lidhur me aktivitetin “Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan” me nr. të prokurimit: 613-23-536-2-2-3.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.N.SH. "Vizion Project" janë parashtruar si në vijim:

"SQARIM: Ky aktivitet i prokurimit është stërzgatur për shkak të vlerësimeve jo reale dhe jo të drejta të AK-së. Në lidhje me vlerësimin e parë, ne e kishim parashtruar ankesë në OSHP dhe ekziston vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0263 dt.22.06.2023 i cili kishte konstatuar shkelje ligjore dhe lënda ishte kthyer në rivlerësim. Gjatë rivlerësimit përsëri ishte bërë vlerësimi në mënyrë subjektive dhe joreale. Pas njoftimit mbi vendimin, ne kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe më pastaj ankesë në OSHP me dt.24.07.2023. Në lidhje me këtë ankesë ishte lëshuar ekspertiza me nr. 2023/0516 me dt.07.08.2023, ku ishte aprovuar tërësisht ankesa jonë dhe është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim. Me datë 26.09.2023 Paneli Shqyrtues i OSHP-së serish nxjerr Vendimin ku konstatohen shkeljet ligjore të AK dhe lënda duhet të kthehet në rivlerësim.

AK, me datë 27.10.2023 ka publikuar njoftimin për vendimin e AK-se lidhur me vlerësimin dhe poentimin e projekteve ideore të paraqitura nga aplikuesit për Konkursin e projektimit për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektin e Qendrës Kulturore në Lipjan, ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit me arsyetimin si më poshtë:

Ky vlerësim i AK-së është shumë subjektiv, i njëanshëm dhe joprofesional sepse ne, në të gjitha kriteret i plotësojmë me pikë maksimale. Është absurditet të na jepen 20 pikë tek kriteri hapësinor, 5 pikë tek kriteri ekonomik e kështu më radhë. Vetë AK-ja bie në kundërshtim me vlerësimet e kaluara kur jemi poentuar me më shumë pikë. Nga veprimet e AK-së kuptohen tendencat që me çdo kusht ne të eliminohejmë nga kjo garë dhe të shpallet fitues një kompani tjetër që është favorizuar që nga fillimi. Ky është vlerësimi i tretë dhe ne vlerësohemi herë më shumë e herë më pak por që asnjëherë nuk bëhet vlerësim i drejtë, objektiv e korrekt, prandaj lidhur me këto shkelje ne nuk do të ndalemi dhe do të apelojmë dhe nëse është e nevojshme edhe ti denoncojmë në organet tjera kompetente. Në njoftimin mbi vendimin e dt.20.04.2023 vlerësimi ishte bërë në këtë mënyrë: Në njoftimin mbi vendimin e dt.20.04.2023 vlerësimi ishte bërë në këtë mënyrë: Në njoftimin mbi vendimin e dt.20.04.2023 vlerësimi ishte bërë në këtë mënyrë: Nga të tre vlerësimet shihen qartë tendencat e AK-së për të favorizuar kompaninë e caktuar dhe diskriminimin e kompanisë tonë. Po ashtu gjatë qasjes në dokumentet nuk na jepen detaje asnjëherë se kush ka qenë në përbërje të komisionit vlerësues dhe cilat janë kualifikimet e tyre, dhe se a janë kompetent dhe profesional për të bërë vlerësimin e këtij konkursi të projektimit. Nga këto dëshmi kuptohet se nuk është respektuar vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0263 dt. 22/06/2023, e po ashtu edhe vendimi i dytë i OSHP-së Nr.2023/0516 i datës 26.09.2023. Në vazhdim, po i prezantojmë argumentet tona, e të cilat pretendime kanë qenë edhe në kërkesën për rishqyrtim dhe ankesa të kaluara, e të cilat

dëshmojnë se vlerësimi i Jurisë Profesionale të caktuar nga Komuna e Lipjanit pas Rivlerësimit lidhur me këtë konkurs projektimi është i paqëndrueshëm profesionalisht dhe ligjërish si dhe në kundërshtim të plotë me Vendimin e OSHP-së. Argumenti 1: Mosrespektimi i rregullativës ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor dhe mbrojtjes nga zjarri nga ana e projekteve pjesëmarrëse në konkursin e projektimit. Bazuar në Detyrën Projektuese të Konkursit të Projektimit për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektin e Qendrës Kulturore në Lipjan, nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK Komuna e Lipjanit kërkon që “Dokumentacioni tekniko projektues të hartohet në harmoni me dokumentet dhe rregullativën ligjore si: Harta Zonale e Komunës së Lipjanit dhe Normat dhe ligjet tjera në funksion të projektimit dhe ndërtimit të objekteve të kësaj natyre”. Po ashtu në përmbyllje të Detyrës Projektuese, AK-Komuna e Lipjanit si informatë shtesë të potencuar me ngjyra të kuqe, kërkon nga të gjithë projektuesit pjesëmarrës që: “Duke pasur parasysh situatën e parcelës ku planifikohet ndërtimi i qendrës kulturore në Lipjan, distancat nga rrugët duhet planifikuar si ne vijim “Nga rruga “Komandant Kumanova” se paku 15 m; Nga rruga “Haxhi Kleçka” se paku 10m; Nga ana perëndimore që kufizohet me objektet e banimit distanca nga vija kufitare duhet të jete se paku 7 m ”Pretendimi ankimor 1.a) Siç vërehet qartë, projektet ideore me shifrat 7373 dhe 1119 nuk kanë respektuar fillimisht obligimet ligjore që kanë të bëjnë me planifikim hapësinor, për arsye se:

Projektuesi me shifrën 7373 në projektin e tij nga ana perëndimore e parcelës, që kufizohet me objektet e banimit distanca nga vija kufitare ka paraparë një distancë prej rreth 2.6m, ndërsa siç shihet më lartë, në Detyrën e dhënë Projektuese kërkohet që “distanca nga vija kufitare duhet të jete se paku 7 m”. Po ashtu, shihet po ashtu qartë se ndërtesa e projektuar nga shifra 7373 në pjesën veriore ka prekur kufirin e parcelës, që është në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore në fuqi të planifikimit hapësinor. Më këto veprime, projektet me shifrat 7373 dhe 1119 kanë shkelur kërkesat obligative ligjore të Detyrës Projektuese të këtij konkursi të projektimit, si dhe rrjedhimisht janë shkelur edhe dispozitat ligjore të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe akteve nënligjore në fuqi të planifikimit hapësinor. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Eksperti shqyrtues ka analizuar skicat e ofruara të projektit – situacionin e ngushtë ku janë të paraqitura dimensionet e pozicionimit të objektit në kuadër të parcelës. Sipas detyrës projektuese AK i ka dhënë kufizimet në kuadër të shtrirjes së objektit duke i deklaruar distancat kufizuese sipas përshkrimit: “Duke pasur parasysh situatën e parcelës ku planifikohet ndërtimi i qendrës kulturore në Lipjan distancat nga rrugët duhet planifikuar si ne vijim ”Nga rruga “Komandant Kumanova” se paku 15m; Nga rruga “Haxhi Kleçka” se paku 10m; Nga ana perëndimore që kufizohet me objektet e banimit distanca nga vija kufitare duhet të jete se paku 7m. Projektuesi me kodin 7373 nga ana perëndimore e parcelës e ka pozicionuar objektin në distancën kufizuese nga parcela në vetëm 2.62m, duke mos respektuar kufizimin e detyrës projektuese që është kërkuar se paku 7m. Këtu gjatë vlerësimit është dashtë të merret parasysh kriteri 4. Kriteri i lëvizshmërisë – nën kriteri Lëvizja pa pengesa e këmbësoreve dhe automjeteve (ku projekti në fjalë është poentuar për këtë kriter me pike maksimale); në këtë rast pengohet – pamundësohet lëvizja e makinave të zjarrfikësve dhe furnizimeve pasi që në këtë

pjesë është vendosur hyrja ekonomike dhe gjerësia nga kufiri i parcelës e deri te objekti është 2.62m'. – Citon Eksperti Teknik i OSHP-së. Komisioni Vlerësues i emëruar nga AK për Rivlerësimin e projekteve sërish ka bërë po te njëjtat shkelje ligjore si komisioni paraprak duke poentuar me pike maksimale projektin me kodin 7373 ani pse Eksperti Teknik e ka bërë të qartë se ky projekt nuk plotëson këtë kriter. Projekti me kodin 7373 duke mos respektuar këto distanca te dhëna nga AK ka shkelur dhe Kriterin 1 – Kriteri Hapësinor me saktë këto nën kritere:

- *Konceptin hapësinor të zgjidhjes urbane;*
- *Cilësia e organizimit të hapësirës*
- *Paraqitja grafike dhe teknike e projektit Projekti me kodin 7373 ka shkelur dhe Kriterin 2 – Kriteri programor me saktë këto nën kritere:*
- *Shfrytëzimi racional i hapësirës*

Respektimi dhe përmbushja e detyrës projektuese dhe programit hapësinor. Duke mos respektuar kriteret e cekura me lartë, Komisioni për vlerësimin e ofertave i AK-së ka shkelur RREGULLAT dhe UDHËZUESIT OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK, përkatësisht nenin 20.9 Specifikimet teknike, ku saktësisht sqarohet se “Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme, të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm.- Projektuesi me shifrën 1119 ne projektin e tij, situacioni nuk është i prezantuar si duhet pasi që në këtë projekt nuk është prezantuar fare përpjesa e vizatimit, si dhe nuk janë dhënë as dimensione se sa është e larguar ndërtesa nga kufiri i parcelë. Kjo e bën të pamundur të dihet dhe të kuptohet se projekti me shifrën 1119 a e ka vendosur ndërtesën në raport të duhur me parcelën, sipas kërkesave të Detyrës projektuese dhe dispozitave ligjore të Ligjit të Planifikimit Hapësinor, Ligjit të Ndërtimit dhe akteve tjera nënligjore të këtij legjislacioni në fuqi. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Pas shqyrtimit të projektit me kodin 1119 eksperti shqyrtues konstaton që projektuesi ne situacionin e ngushte nuk i ka paraqitur të dhënat e kompletuara dhe është i mangët, sipas ligjit të ndërtimit dhe rregullave të projektimit, ne rast se mungon vija e ndërtimit – dimensionet e pozicionimit të objektit në kuadër të parcelës ose koordinatat gjeodezike përmes të cilave do te pozicionohej objekti. Rregullorja nr.001-2022, Neni 55.1 Konkursi për projektim është një procedurë në bazë të së cilës ftohen Operatorët Ekonomik që ta dorëzojnë projektimin ideor të tyre të një projekti fizik. Projektimi ideor që formon komponentin kryesor të Konkursit për Projektim pritet t'i nxjerr në pah aspektet estetike të projektit përveç karakteristikave teknike. Projektimi ideor është një projektim preliminar që do

të pasohet me një projektim të detajuar. Do të thotë që mangësitë e cekura në projektin ideor i pamundësojnë komisionit një vlerësim real mbi kriteret e kërkuara për vlerësimin në dosje të tenderit (kriteri hapësinor, kriteri programor, kriteri i lëvizshmërisë) dhe këto mangësi duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të projekteve në poentimin e tyre. Marrë parasysh këto fakte konsideroj që sa i përket pikës 1.a) pretendimi 1 – për kodin 7373 dhe kodin 1119 pretendimi është i bazuar. – Citoj Eksperti Teknik i OSHP-së. Komisioni Vlerësues i emëruar nga AK për Rivlerësimin e projekteve serish ka vepruar kundërligjshëm pasi që nuk ka marrë parasysh fare Vendimin e OSHP-së si dhe nuk ka respektuar kriteret bazë të dhëna në FDT dhe nuk ka respektuar Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Komisioni serish e ka poentuar me pike projektin me kodin 1119 ani pse ky projekt nuk plotëson asnjë nga kriteret e dhëna në FDT. Duke mos respektuar kriteret e cekura me lartë, Komisioni për vlerësimin e ofertave i AK-së ka shkelur RREGULLAT dhe Udhëzuesit Operativ Për Prokurimin Publik, përkatësisht nenin 20.9 Specifikimet teknike, ku saktësisht sqarohet se “Specifikimet teknike janë kërkesa të obligueshme, të cilat të gjithë tenderët duhet të respektojnë në mënyrë që të jenë të përgjegjshëm. 1.b) Po ashtu, vërehet qartë që projekti ideor me shifrën 7373 nuk ka respektuar as obligimet ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga zjarri për arsye se:- Në projektin e tij nuk janë prezantuar dhe planifikuar fare DALJET EMERGJENTE, që është obligim ligjor në Kosovë.

Më këto veprime, projekti me shifrën 7373 ka shkelur RREGULLOREN Nr. 24/2012 PËR NORMAT TEKNIKE PËR MBROJTJE NGA ZJARRI TË OBJEKTEVE TË LARTA, përkatësisht Nenin 30 të kësaj rregulloreve, ku përcaktohet qartë nevoja dhe mënyra e planifikimit të Korridorit dhe rrugës së evakuimit emergjent. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Eksperti shqyrtues konsideron që duke pasur parasysh rëndësinë e projektit – Kategoria II e objekteve, duhet trajtuar aspektin e sigurisë dhe lëvizshmërisë së personave dhe makinerisë në raste emergjente, pasi që ka qene edhe kriteri 4 i vlerësimit – Kriteri i lëvizshmërisë. Projektuesi në projektin ideor i cili është bazë për hartimin e projektit kryesorë nuk i ka paraqitur dyert emergjente. Për shkak të sigurisë së objektit në rast fatkeqësie duhet parapare daljet emergjente direkt jashtë objektit. Eksperti shqyrtues konstaton që pretendimi ankimor në pikën 1n) janë të bazuara. - Citoj Eksperti Teknik i OSHP-së. Përgjigje në pretendimin – Argumenti 1 Eksperti konstaton se në aspektin e mbrojtjes nga zjarri ligji për mbrojtje nga zjarri Neni 12.4. Me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv, objekteve publike, qendrave tregtare, hoteleve, kinemave, teatrove, bibliotekave, postave, spitaleve, hallave sportive, pallateve koncertale si dhe objekteve tjera publike, duhet të sigurohen kushtet për evakuim të njerëzve në rast të shpërthimit të zjarrit me ndërtimin e shkallëve për evakuim si dhe pajisje përkatëse për alarm dhe fikje të zjarrit. Andaj gjatë hartimit të projektit ideor projektuesi duhet ti parasheh të gjitha parametrat në aspektin e sigurisë dhe lëvizjes së lirë në dhe përreth objektit. Po ashtu projektuesi, projekti ideor duhet të përmbaj situacionin e gjerë dhe të ngushtë konform normave të projektimit në përpjesë 1:200 ose 1:500 duke përfshirë Vijat e ndërtimit nga skajet e kufijeve të parcelave deri të objekti. Eksperti vlerëson se pretendimi ankimor në argumentin 1 është i bazuar dhe se AK gjatë vlerësimit të projekteve duhet merr parasysh faktet e cekura dhe ti zbatoj në kriteret për poentimin e

projekteve. Citon Eksperti Teknik i OSHP-së. Komisioni Vlerësues i Projekteve nuk ka marrë parasysh asnjë Kriter dhe nuk ka marrë parasysh fare Detyrën Projektuese të dhënë në Dosjen e Tenderit dhe po ashtu nuk ka respektuar një Vendim të dalë nga OSHP-ja. Argumenti 2: Mosrespektimi i Detyrës Projektuese dhe kriterëve profesionale të projektimit të ndërtesave kulturore. Bazuar në Detyrën Projektuese të Konkursit të Projektimit për zgjidhjen e projektit ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektivin e Qendrës Kulturore në Lipjan, nga OE-të që synonin pjesëmarrjen në këtë konkurs projektimi, AK-Komuna e Lipjanit paraqet kërkesa shumë specifike që nuk janë respektuar nga projektet 7373, 1001 dhe 1119.2a) Në Detyrën Projektuese tek kapitulli Hapësira e përgjithshme e objektit, AK kërkon që Sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore të jetë minimum 8900 dhe max 9200 m².

Projektet me shifrat 7373 dhe 1001 nuk kanë dhënë fare sipërfaqe totale të ndërtesës së Qendrës Kulturore dhe në këtë mënyrë e kanë bërë të pamundur vlerësimin se a është respektuar nga to ky kriter. Projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 nuk kanë respektuar as kërkesat e Detyrës Projektuese dhe normat teknike të projektimit të Sallës së madhe dhe sallës koncertale me hapësirat tjera mbështetëse, të . Argumentet tona të qëndrueshme që e dëshmojnë këtë mosrespektim sa i përket 2 Sallave dhe hapësirave tjera mbështetëse janë me sa vijon. Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 7373:- Në këtë projekt shihet qartë se nuk është planifikuar erë mbrojtësi i Sallës së madhe;- Projekti 7373 nuk ka planifikuar erë mbrojtës as për sallën koncertale; Duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat e Sallës së madhe dhe të Sallës koncertale, mungesa e erë mbrojtësit pamundëson funksionimin adekuat të këtyre dy hapësirave për arsye se mundësohet që zhurma nga holli të depërtojë në brendësi të këtyre dy hapësirave;- Salla koncertale nuk është projektuar sipas standardeve të projektimit të sallave koncertale, për arsye se e gjitha është projektuar në të njëjtin nivel të lartësisë (si skena, ashtu edhe pjesa e auditoriumit)- Salla e madhe hyrjen për furnizim të skenës dhe të hapësirave tjera teknike e ka të ngushtë (dera është 1,00 m korridor 1,20 m, duke pamundësuar kështu funksionimin e duhur të sallës së madhe me kapacitet 450 deri 500 persona)- Projekti me kodin 7373 hapësirën e Kaldatores e ka përfshirë në korridorin hyrës të Sallës së madhe, ku janë hapësirat përcjellëse të sallës. Në këtë mënyrë projektuesi me kodin 7373 në këtë pjesë ku është qasja e artistëve ka planifikuar furnizimin me lëndë djegëse për ngrohje, duke penguar dhe rrezikuar komunikimin dhe funksionimin e sallës së madhe;- Projekti me kodin 7373 nuk ka planifikuar dalje emergjente për asnjërën sallë. Me këtë veprim janë shkelur dispozitat ligjore të Rregullores Nr. 24/2012 Për Normat Teknike Për Mbrojtje Nga Zjarri Të Objekteve Të Larta;- Pjesa e regjisë dhe e projektorit të Sallës së madhe nga projektuesi 7373 është vendosur gabimisht dhe në mënyrë jofunksionale në pjesën prapa skenës së sallës së madhe, në vend se të planifikohen në pjesën pas ulëseve të auditoriumit (në pjesën përballë skenës, ku duhet të shihet nga regjia skena dhe të projektohen pamje nga projektori);- Lartësia e Sallës së madhe nga projektuesi 7373 është planifikuar të jetë përafërsisht 5 metra, që është lartësi e papranueshme duke pasur parasysh kapacitetin e sallës së madhe prej 450-500 personave. Me këtë lartësi është e pamundur të funksionojë si duhet skena e sallës së madhe;- Në prerjen e Sallës së madhe nuk është prezantuar as “Lakorja e Gylenikut” në bazë të së cilës sipas standardeve të projektimit të sallave

koncertale bëhet projektimi i këtyre sallave. Duke mos e prezantuar këtë analizë të domosdoshme të projektimit të sallës së madhe, është e pamundur të vlerësohet se a është siguruar shikimi i papenguar i secilit shikues në auditoriumin e Sallë së madhe;- Pjesa e prapaskenës së Sallës së madhe nuk është projektuar sipas standardeve të projektimit të sallave koncertale. Projektuesi 7373 këtë hapësirë të prapaskenës e ka bërë shumë të vogël në raport me kapacitetin e sallës së madhe. Kjo hapësirë përveç që është e vogël si sipërfaqe funksionale, po ashtu i mungojnë edhe hapësirat tjera përcjellëse të skenës, siç janë dhoma e provave, akordimi i instrumenteve, ndërsa hapësirën e gardërobave projektuesi 7373 e ka projektuar me sipërfaqe të pamjaftueshme. Është e rëndësishme të potencohet se projektuesi 7373 në këtë hapësirë funksionale të sallës dhe të artistëve nuk ka arritur të bëjë lidhshmërinë e duhur funksionale të hapësirave mes tyre.

Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 1001:- Ky projekt nuk ka planifikuar hyrje ekonomike për Sallën e madhe;- Nuk ka planifikuar erë mbrojtës për Sallën e madhe dhe po ashtu erë mbrojtës nuk ka planifikuar as për Sallën koncertale;- Projektuesi 1001 tek Skena e teatrit dhe kinemasë nuk ka planifikuar pajisjen me sistem fleksibil – platformë lëvizëse e cila mundëson formimin e hapësirës për orkestrën në pjesën e skenës, ashtu siç është kërkuar në Detyrën Projektuese; Mosrespektimi nga ana e projektit me shifër 1119:- Projekti 1119 nuk e ka projektuar si duhet skenën për Sallën e madhe, kjo pasi që lartësia e saj dhe mënyra se si është paraparë të funksionoj skena në projektin në fjalë është e gabueshme në raport me standardet për projektimin e skenave dhe në raport me numrin e kapacitetit të auditoriumit.- Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk ka paraparë erëmbrojtës në hyrje të sallave, element ky i cili kërkohet në projektimin e auditoriumve: erëmbrojtësi apo korridori me dy dyer në hyrje të shikuesve kërkohet në mënyrë që zhurma nga holli të mos depërtojë në sallë.- Si pjese përcjellëse e Sallës së madhe dhe Sallës koncertale duhet të jenë edhe gardërobat për pjesën e shikuesve. Këtë hapësirë të domosdoshme përcjellëse për këto salla, projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk e ka vendosur fare.2b)Projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 nuk kanë respektuar as kërkesat e Detyrës Projektuese dhe normat teknike të projektimit të Hapësirave skenike dhe auditoriumit, të Hollit hyrës dhe foajeut, të Hapësirave administrative dhe të Hapësirave të jashtme. Argumentet tona të qëndrueshme që e dëshmojnë këtë mosrespektim janë me sa vijon.- Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij, në pjesën e prerjeve, nuk e ka paraqitur si duhet skenën fleksibile të Sallës së madhe, duke mos ju përmbajtur Detyrës projektuese. Në Detyrën projektuese tek Hapësirat skenike dhe auditorium kërkohet saktësisht që: “Skena e teatrit dhe kinemasë të jetë e pajisur me sistem fleksibil – platformë lëvizëse e cila mundëson formimin e hapësirës për orkestrën në pjesën e skenës”. Ndërsa, projekti me shifrën 1001 ka paraqitur vetëm skenën statike. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Pretendimi për projektin 1001 për skenën fleksibile të sallës së madhe – platformë lëvizëse është trajtuar më sipër dhe ky pretendim është i bazuar. Duhet të merret parasysh tek kriteret e poentimit gjatë vlerësimit të projekteve. Citon Eksperti Teknik i OSHP-së.”

Komisioni i Vlerësimit të Projekteve nuk e ka marrë për bazë fare këtë kriter dhe po ashtu nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së.- Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij nuk e ka vendosur të gjitha kthinat dhe përmbajtjet në pjesën e teknikës dhe regjisë, duke mos ju përmbajtur detyrës projektuese dhe normave teknike për funksionimin e sallës.- Projekti me shifrën 7373 në projektin e tij nuk ka parapare gardëroba për pjesën e Sallës koncertale, dhe me këtë nuk i është përmbajtur detyrës projektuese dhe normave teknike se si duhet te projektohet salla koncertale.- Projekti me shifrën 1001 në projektin e tij nuk i është përmbajtur detyrës projektuese ku kërkohen 10 zyre për stafin, ai nuk e ka plotësuar këtë pike. Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Eksperti konstaton se projektuesi nuk ju ka përmbajtur detyrës projektuese në këtë pikë dhe e konsideron si të bazuar. Komisioni i vlerësimit duhet të merr parasysh gjatë vlerësimit tek kriteret për poentim. Citon Eksperti Teknik i OSHP-së. Komisioni i Vlerësimit të Projekteve nuk e ka marrë për bazë fare këtë kriter dhe po ashtu nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së.- Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk e ka prezantuar situacionin dhe përdhësen si duhet, pasi që nuk mund te lexohet projekti se ku ka gjelbërim, parkingje apo shtigje te ecjes, duke mos iu përmbajtur detyrës projektuese e cila kërkon që te trajtohet edhe pjesa e oborrit;- Projekti me shifrën 1119 në projektin e tij nuk ka parapare vendosjen e një ekrani Led siç është kërkuar në detyrën projektuese; Për këtë pretendim ankimor ka dhënë përgjigje dhe Eksperti Teknik i OSHP-së ku citon: Pas shqyrtimit të fakteve të përmendura eksperti shqyrtues konstaton se në detyrën projektuese janë të përcaktuara kërkesat për lokacionin dhe rregullimin e hapësirave të jashtme, gjithashtu edhe kriteri kryesor gjatë vlerësimit të projekteve – Kriteri hapësinor. Pretendimi është i bazuar dhe duhet merret parasysh gjatë vlerësimit të projekteve në poentim, mbarim citati. KONKLuzion si konkluzion mund të thuhet se Juria Profesionale e caktuar nga AK-Komuna e Lipjanit pas Vendimit të OSHP-së që lënda të kthehet në Rivlerësim dhe pas lëshimit të ekspertizës së fundit të dt.07.08.2023 Nr.2023/0516 përsëri nuk ka bërë vlerësim të drejtë të projekteve pjesëmarrëse në këtë konkurs projektimi, duke na diskriminuar rrënjësisht neve si OE pjesëmarrës në këtë konkurs projektimi dhe duke e anuluar këtë aktivitet të prokurimit dhe duke shpallur vlerësuar në mënyrë joreale projektet që nuk kanë respektuar kërkesat e Detyrës projektuese dhe rregullativën ligjore në fuqi, ka shkelur rëndë dispozitat ligjore të LPP-së. Po ashtu ky komision i krijuar për Rivlerësimin e Projekteve Ideor nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së në të cilin Vendim është shumë e qartë se asnjëri nga shifrat 7373,1119 dhe 1001 nuk i ka përmbushur Kriteret e dhëna në FDT dhe po ashtu nuk ka respektuar Specifikimet Teknike të Detyrueshme.

Nga këto dëshmi kuptohet qartë se AK-së nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së Nr. 2023/0263 dt. 22/06/2023 dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues Nr.2023/0516 të dt.07.08.2023.Është konstatuar nga këto dëshmi se projektet me shifrat 7373, 1001 dhe 1119 bazuar në mosrespektimin e kërkesave të Detyrës Projektuese të këtij konkursi projektimi dhe rrjedhimisht edhe të rregullativës ligjore në fuqi, janë projekte të papërgjegjshme. Me datën 06.11.2023 autoriteti kontraktues ka publikuar vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim është

arsyetuar duke e cekur se Komuna nuk ka ndonjë tendencë, mirëpo kërkon një projekt i cili do ti plotësonte nevojat e banorëve të Komunës së Lipjani dhe do të pasqyronte vlerat kulturore të Lipjanit, ndërsa në vazhdim i ka përsëritur pothuajse të gjitha arsyet e njëjta sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së .Pikërisht si është kërkuar ne kemi ofruar detaje të projektit dhe projekti është shumë profesional. Sa i përket arsyeve të tjera të cekura në vendimin për refuzim, ju sqarojmë se këto tendenca dhe arsye nuk janë dhënë në letrën standarde, prandaj autoriteti kontraktues është munduar tani të bëjë arsyetime të supozuara dhe të imagjinuara në lidhje me projekti tonë. Prandaj këto çështje nuk janë pjesë e letrës standarde dhe nuk mund të shqyrtohen në këtë fazë, pavarësisht se janë tërësisht të paqëndrueshme. Të gjitha pretendimet që janë dhënë në vendimin për refuzim kanë të bëjnë me çështje subjektive dhe joprofesionale. Në edhe një herë po e sqarojmë se ne si kompani e përgjegjshme kemi ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe se projekti ideor i yni i plotëson të gjitha kriteret dhe i njëjti projekt është dashur të vlerësohet me pikët maksimale. Se në këtë aktivitet të prokurimit jemi diskriminuar, e vërteton fakti se në vlerësimet e kaluara ne jemi poentuar me më shumë pikë, ndërsa tani jemi poentuar me më pak se herët e kaluara. Andaj arsyetimi i AK-së se kinse nuk ka tendenca kundrejt kompanisë tonë, bien poshtë, pasi që ky është vlerësimi i tretë me radhë dhe ne vlerësohemi herë më shumë e herë më pak poena por që asnjëherë nuk bëhet vlerësim i drejtë, objektiv e korrekt, prandaj lidhur me këto shkelje (pa dashur që të merret si kërcënim një konstatim i tillë), ju sqarojmë se ne nuk do të ndalemi dhe do ti apelojmë dhe nëse është e nevojshme edhe ti denoncojmë në organet tjera kompetente. Autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysht fare pretendimet tona ankimore kundrejt OE të tjerë të cilët kanë ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit dhe njëkohësisht nuk është përgjigjur në pretendimet tona ankimore, në lidhje me mos respektimin e panelit shqyrtues dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues të OSHP-së. Nga këto fakte kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, është i pa bazuar sepse e njëjta po vazhdon përsëri duke bërë shkelje dhe duke mos i respektuar dispozitat ligjore të LPP-së. Duke pasur parasysht faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i projekteve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe nuk është bërë në harmoni me dispozitat e nenit 73-80 të LPP-së sepse juria nuk ka bërë vlerësim objektiv në këtë rast, Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi kualifikuar tutje, kurse paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër N.N.SH. “Vizion Project” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 2, 6, 7, 10, 59, 60, 62, nenin 73-80 Rregullat Për Konkursat e Projektimit si dhe nenin 80 , te LPP-së Neni 55 i Rregullores nr.001/2022 Për prokurim Publik Vendimi i

OSHP-së Nr. 2023/0263 dt.22.06.2023. Duke propozuar qe ankesa të APROVOHET, ankesa e grupit të OE N.N.SH. " Vizion Project & REBUS ARCHITECTS L.L.C. & ArchiUNIK SH.P.K., si e bazuar ANULOHET, njoftimi mbi vendimin (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM, DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. OBLIGOHET autoriteti kontraktues të respektoj vendimi i OSHP-së Nr. 2023/0263 i dt. 22/06/2023 dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues Nr.2023/0516 të dt.07.08.2023 Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: “Përgjigje për projekt idenë tuaj! Ne këtë rast Komuna nuk ka ndonjë tendence mirëpo kërkon një Projekt i cili do të plotësonte nevojat e banoreve të Komunës së Lipjanit dhe do të pasqyronte vlerat kulturore të Lipjanit .Hyrja kryesore e prezantuar për publikun nuk lejon një hyrje në kuptimin monumental ashtu qe publikut ti ofroj një madhështi. Hyrja për artistet e propozuar në pjesën nga parkingu publik.Daljet emergjente nga salla ndikohen nga pjesa e rampës. Elementet në fasade nuk krijojnë ndonjë harmoni mes vete shikuar nga aspekti kulturor.Rregullimi i parterit nuk krijon ndonjë pamje ashtu që të shfrytëzohet si amfiteatër i jashtëm në të cilin do të realizohen shfaqje të ndryshme gjithashtu koncepti krijon tri grupe që nuk paraqesin ndonjë lidhmëni mes vete.Planifikimi i hapësirës reklamuese nuk pasqyron kërkesat për zhvillim të ngjarjeve, krijohet shkëputje me ambientin dhe vlerat kulturore në fasade, ne raport me një fasade vizuale krijojnë jo kontinuitet gjallëri dhe informacion për ngjarjet që do të trajtonte vlere unike për qytetin ashtu që publiku i jashtëm të jetë në të njëjtën kohë edhe spektator.Hapësirave të gjelbrat nuk i është kushtuar kujdes zgjerimit të sipërfaqeveDuke iu referuar Konceptit nga historiku varrezat e popullit të lashtë të pashtrikut, "Barka e Blinajes", shtëpia e Gjeçovit e cila gjendet në Janjeve e jo në qendër të Qytetit lejon një konfuzion në kuptim të rëndësisë historike dlie baza për krijimin e Konceptit.Gjithashtu te kriteri ekonomik nuk janë trajtuar grupimet të cilat do të funksiononin të ndara në kuptim të menaxhimit dhe funksionimit.Shfrytëzimi i paneleve solare është pjesë që merret parasysh, mirëpo e njëjta do të jete edhe variant tjetër i sistemit të ngrohjes së qytetit i cili planifikohet në vitet në vijim.Pjesa e Sheshit nuk ka marrë për bazë rregullimet në kuptim të zhvillimit të ngjarjeve dhe hapësirave për të gjithë që në të njëjtën kohë te paraqet ngjarjet, manifestimet, kulturën dhe historinë e Lipjanit”.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 18.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 909/23, ndërsa me datë 30.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0909 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar pajtohem me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "N.N.SH. " Vizion Project "- Prishtinë - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/909. ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim: Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit ka zhvilluar procedurën e prokurimit Konkurs Projektimit me titull: Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan. Nr. Prokurimi 613-23-536-2-2-3 Për këtë aktivitet të prokurimit është dorëzuar një ekspertizë nga eksperti shqyrtues me datën 19.05.2023 ku rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim. Për të njëjtin aktivitet është përpiluar edhe një super ekspertizë qe është dorëzuar me datën 19.06.2023 ku eksperti Teknik rekomandon qe lënda të kthehet në rivlerësim. Vendimi i PSH me nr. 2023/0263 i datës 22.06.2023 ku kërkohet qe lënda te kthehet në rivlerësim. Prapë është ankuar OE i njëjtë dhe eksperti shqyrtues ka dorëzuar ekspertizën me nr. 2023/516 të datës 07.08.2023 ku rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim. mVendimi i PSH i datës 2023/516 i datës 26.09.2023 ku lënda kthehet në rivlerësim. AK-ja ka publikuar vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit më datën 27.10.2023 AK gjatë përgjigjes ndaj kërkesës se ekspertit shqyrtues ka ngritur edhe çështjen e zvogëlimit te buxhetit por që nuk ka bashkangjitur ndonjë dëshmi për zvogëlim te buxhetit. Poashtu vlen të theksohet se në këtë fazë anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është bazuar në mungesë apo shkurtim të buxhetit dhe rrjedhimisht nuk është marrë parasysh.”

Përgjigje në Pretendimin nr.1: “Lidhur me pretendimet e OE ankues eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet janë te njëjta me pretendimet te cilat janë te shtjelluara ne super ekspertizën me nr. 263/23 te dorëzuar me datën 19.06.2023 dhe te njëjtave u është dhënë

*përgjigje.Sa i përket pretendimit Argumenti 1 – pretendimi 1.a) qe ka te bëjë me projektet me kodet 1119 dhe 7373, pretendimin 1.b) për projektin me kodin 7373 eksperti Teknik i ka cilësuar si te bazuara dhe ka rekomanduar qe këto mangësi te merren ne konsiderate gjate rivlerësimit te projekteve.Sa i përket pretendimit Argumenti 2 pretendimi 2a) është vlerësuar i pabazuar. Pretendimi ankimor për mos përmbushje të detyrës projektuese për projektin me kod 7373 është vlerësuar i pabazuar, ndaj projektit me kodin 1001 pjesërisht i bazuar, ndaj projektit me kodin 1119 i pabazuar.Ndërsa për pretendimin 2.b) për pretendimin ndaj projektit me kodin 1001 e skenës fleksibile te sallës se madhe dhe mosvendosjen e kthinave është vlerësuar i pabazuar, pretendimi ndaj projektit me kodin 7373 qe nuk ka paraparë gardërobë për pjesën e sallës koncertale i pabazuar, pretendimet ndaj projekti me kodin 1001 ne pikën ku kërkohen 10 zyre për stafin te cilat nuk iu është përmbajti si dhe kriterit hapësinor është vlerësuar e bazuar dhe ka rekomanduar të merret parasysh gjatë vlerësimit te projekteve.Në bazë të ekspertizave PSh ka marrë vendimin që lënda të kthehet në Rivlerësim.Sa i përket pretendimeve te shtjelluara me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se janë çështje qe duhet te trajtohen ne bazë te nenit 105 paragrafi 2-16 te LPP-se si çështje të gjykuara “**res judicata**” dhe për te njëjtat nuk do të jap vlerësim.*

Përgjigje në Pretendimin nr.2: *“Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me mosrespektimin e vendimeve te OSHP eksperti shqyrtues sqaron se ne vlerësimin e AK-se te datës 07.07.2023 si rezultat i vendimit te OSHP-se ka rezultuar ne vlerësimin e projekteve si me poshtë:AK-ja gjate rivlerësimit ka vlerësuar projektin me kodin 1119 me pak për 9.48 poenë, projektin me kodin 1001 me pak për 11.35 poenë dhe projektin me kodin 7373 me pak për 23.75.Sipas dosjes se tenderit pika 23.1 Pikët Totale për kriteret: 100, ndërsa pragu minimal 50 pikë për te kaluar ne fazën e II-te (hapja e zarfeve te kandidatëve).Prandaj nga kjo shihet se projektet te cilat kontestohen nga OE ankues ne këtë vlerësim nuk kane kaluar prapun.Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues se AK nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-se nuk qëndron nga vet fakti se në rivlerësim sikurse është kërkuar me vendim dhe ekspertizë mangësitë e vërtetuara janë reflektuar ne poentimin e komisionit te vlerësimit prandaj ky pretendim nuk është i bazuar.*

Përgjigje në Pretendimin nr. 3: *“Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me vlerësimin e projektit duke u bazuar dhe krahasuar me kërkesat e konkursit te projektimit eksperti shqyrtues sqaron se komisioni i vlerësimit ne vlerësimin e datës 27.10.2023 ka vlerësuar si me poshtë: Ndërsa ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim te bere nga OE ankues AK-ja kishte arsyetuar vendimin e tij si me poshtë: përgjigje ndaj kërkesë për rishqyrtim.*

Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i komisionit te vlerësimit për mos përmbushjen e kërkesave nga ana e projektit me kodin 1124 nuk është i mbështetur ne kërkesat e dosjes se

*tenderit dhe kërkesat teknik dhe estetike te konkursit te projektimit. Për me tepër arsyet e dhëna për mos kualifikim te OE ankues ne vendimin ne kërkesën për rishqyrtim nuk janë ne përputhje me gjetjet e komisionit të vlerësimit. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjate vlerësimit te projektit te OE ankues nuk e ka bërë në përputhje me nenin 80.2 të LPP-së dhe se pretendimi ankimor i OE ankues në vlerësimin e **projektit është i bazuar.**”*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“N.N.SH. " Vizion Project ”**- Prishtinë Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e **“Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatuese për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.”** me nr. të prokurimit: **"613-23-536-2-2-3"**. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“N.N.SH. " Vizion Project ”**- Prishtinë dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“N.N.SH. " Vizion Project ”**- Prishtinë janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues vlerëson duke u mbështetur në raportin e ekspertizës se arsyetimi i komisionit të vlerësimit për mos përmbushjen e kërkesave nga ana e projektit me kodin 1124 nuk është i mbështetur ne kërkesat e dosjes se tenderit dhe kërkesat teknik dhe estetike të konkursit të projektimit. Për me tepër arsyet e dhëna për mos kualifikim të OE ankues ne vendimin ne kërkesën për rishqyrtim nuk janë ne përputhje me gjetjet e komisionit të vlerësimit. Si rredhoj, AK vlerësimin e projektit të OE ankues nuk e ka bërë në përputhje me nenin 80.2 të LPP-së.

- Përfundim-

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.”** me nr. të prokurimit: **"613-23-536-2-2-3"**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me **“Konkurs projektimi për zgjidhjen e projektit Ideor për hartimin e projektit zbatues për Objektin e Qendrës Kulturore ne Lipjan.”** me nr. të prokurimit: **"613-23-536-2-2-3"**, të rivlerësohet AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LLP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - N.N.SH. " Vizion Project "**
- Arkivës së OSHP-së: